



PROCESVERBAL NGA MBLEDHJA E KOMISIONIT QENDROR TË ZGJEDHJEVE

Mbledhja: Nr. 29

Datë: 29. 04. 2024

Fillimi i takimit: Ora: 13:30

Vendi: Selia e KQZ-së/ Prishtinë

Kryesoi: Kreshnik Radoniqi, Kryesues i KQZ

Anëtarët e KQZ-së prezentë: Sami Kurteshi, Alban Krasniqi, Ilir Gashi, Sami Hamiti, Arianit Elshani, Ibrahim Selmanaj, Gordana Llaban, Mufera Shinik, Fazli Stollaj

Nga SKQZ: Burim Ahmetaj, kryeshef i SKQZ; **Nga ZRCKFSP:** Besnik Buzhala, drejtor i ZRCKFSP; **Përkthyes:** Argjina Misini; Jehona Cami; **Procesmbajtës:** Fehmi Ajvazi

RENDI I DITËS

1. Hyrje: z. Kreshnik Radoniqi, Kryesues i mbledhjes së KQZ-së

Aktivitetet e SKQZ

Raportet e Këshillave të KQZ

4.1. Këshilli për Operacione

1. Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit të punës së KQZ për vitin 2023, për Kuvendin e Kosovës
2. Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit të realizimit të Planit të Punës së KQZ për vitin 2023
3. Shqyrtimi dhe miratimi i sloganit, përmbajtjes dhe dizajnit të fletëpalosjes, lapsë kimikëve, byzylykëve, stikersave, maicave, fletëvotimit dhe skenarit për realizimin e videos për projektin për edukimin dhe informimin e votuesve të rinj

4. Kërkesë për përkrahjen e KQZ-së nga OSBE-ODIHR

4.2. Këshilli për Personel

- Shqyrtimi i draft Vendimit për ekuivalentimin dhe ruajtjen e pagave sipas Aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese

5. Të ndryshme

1. Hyrje: z. Kreshnik Radoniqi, Kryesues i mbledhjes së KQZ-së:

Në fillim të takimit, nga kryetari Radoniqi u paraqitë agjenda e mbledhjes. Pas kësaj, Alban Krasniqi tha se ka një pikë në formë 'njoftimi', ndërsa Sami Kurteshi tha se, raporti i punës të mbetet në fund sepse, nuk është produkt final.

Arianit Elshani, u pajtua që pikat e KOZ të jenë pas këshillit për personel, dhe si pikë e fundit – e katërt të jetë diskutimi për raportin.

Miraitmi i rendit të ditës, u bë me 10 vota për.

Këshilli për Personel

Shqyrtimi i draft Vendimit për ekuivalentimin dhe ruajtjen e pagave sipas Aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese:

Alban Krasniqi, tha se nuk e kemi përkufizue këtë pikë. Ka mbetur që edhe me ekspertin, të trajtohet edhe njëherë. Ta kemi formatin përfundimtar të një draft – vendimi që, duhet të jetë i bazuar në aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese.

Ne kemi kërkuar edhe një raport përmbledhës për çështjet tjera që janë në proces gjyqësorë me palët e treta, sa i përketë nivelit të pagave. Ngase, është aprovue rregullorja e brendëshme, kja ka ndikue edhe në çështjen e hapësirave të brendëshme sipas, organogramit. Do ti shqyrtojmë edhe njëherë, dhe do ti sjellim në mbledhje.

Sami Kurteshi, pyeti nëse do ta kemi një raport lidhur me hartimin dhe miratimin e një procesi të rregulloreve të brendëshme, si është bërë edhe vlerësimi nga komisioni, dhe mendoj se kjo duhet të jetë në një nga mbledhjet e ardhshme.

Alban Krasniqi, tha se kjo është e paraparë edhe me rregulloret e brendëshme, me detyrimet e brendëshme që të themelohet një komision i këtillë... Natyrisht, mund të kërkojmë 'një njoftim' nga komisioni mbi transferet, kriteret, sistematizimin etj.

Raportet e Këshillave të KQZ

4. Këshilli për Operacione

1. Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit të punës së KQZ për vitin 2023, për Kuvendin e Kosovës:

Arianit Elshani e informoi KQZ –në se KOZ, ka shqyrtuar dhe miratuar Raportin e punës të KQZ për vitin 2023 për Kuvendin e Kosovës. Ky raport është shqyrtuar edhe në mars, por zgjedhjet që kishim e prolonguan. Mirëpo, tani e kemi shqyrtuar dhe nga 59 aktivitete nga plani i punës 2023, janë realizuar 44 aktivitete, 4 pjesërisht dhe 11 aktivitete nuk janë realizuar.

z. Elshani, dha shpjegime se pse disa aktivitete nuk janë zbatuar!

Me 10 vota për, u miratua raporti i punës së KQZ për vitin 2023 për Kuvendin e Kosovës.

2. Shqyrtimi dhe miratimi i sloganit, përmbajtjes dhe dizajnit të fletëpalosjes, lapsë kimikëve, byzlykëve, stikersave, maicave, fletëvotimit dhe skenarit për realizimin e videos për projektin për edukimin dhe informimin e votuesve të rinj:

Arianit Elshani, referoi edhe mbi aktivitetin e projektit për edukimin dhe informimin e votuesve të rinj. Pra, është miratuar slogani, përmbajtja dhe dizajni i fletëpalosjes, lapsat kimikë, byzlykët, stikersat, maicat, fletëvotimet dhe skenari për realizimin e videos për projektin për edukimin dhe informimin e votuesve të rinj. Projekti është duke u zhvilluar në gjithë vendin, kryesisht në shkollat e mesme.

Me 10 vota për, u miratua raporti i punës së KQZ për vitin 2023 për Kuvendin e Kosovës.

3. Kërkesë për përkrahjen e KQZ-së nga OSBE-ODIHR:

Arianit Elshani, tha se KOZ ka shqyrtuar një dokument të përgatitur nga Sekretariati për kërkesat drejtuar OSBE-ODIHR për procedura të rekrutimit, a tenderimit. Janë disa pika që duhet ti trajtojmë, ti shqyrtojmë si për shembull, themelimi i një qendre trajnimi. Kemi bërë disa hapa edhe ne...

Në vijim, z. Elshani, elaboroi në detaje planet, mundësitë, nevojat lidhur me identifikimin dhe realizimin e disa kërkesave në formë projektsh të nevojshme për proceset zgjedhore, ngritjen e kapaciteteve: identifikimi elektronik i votuesve, vizita studimore sepse jemi në përgatitje të një soufuri, komunikimi i brendshëm, informimi dhe edukimi publik...

Këto janë, pak a shumë të gjitha kërkesat që konsiderojmë se mund të miratohen, tha z. Elshani.

Kjo pikë, pati vëmendje të gjerë, prandaj në këtë pikë shtruan pyetje, diskutuan, analizuan dhe dhanë mendimet e tyre anëtarët: Sami Kurteshi, Ilir Gashi, Sami Hamiti, Ibrahim Selmanaj, Arianit Elshani, alban Krasniqi.

Në fund, me nëntë vota për dhe një kundër (Ilir Gashi), u miratua Kërkesa për përkrahjen e KQZ-së nga OSBE-ODIHR.

(Pikë e mbyllur)

4.Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit të punës së KQZ për vitin 2023, për Kuvendin e Kosovës

Arianit Elshani:Zoti Kurteshi ka dhënë komente përmes imellit lidhur me disa përmirësime, por drejtorët e Sekretariatit nuk kanë dhënë asnjë sugjerim, asnjë rekomandim, nuk e di a nuk kanë vizion a pse...?

Samir Kurteshi: Unë, i kam bërë disa ndryshime, te tabela...pastaj, te fq. 10 'kompetencat e KQZ', misioni – vizioni por mungojnë në përmbajtje, nuk janë ba ndryshimet... Nëse shkojmë me rend: te fjala e kryesuesit kam ba pak ndryshime fq. 6). Nuk i kam dërgu, por ua dërgoj... Teknikisht, ka probleme: përzihen tabelat me grafikat...

Kam vërejtje edhe ku janë vendosur 'këshillat', 'struktura', 'komisionet', rendidjta e tyre...

I kam bërë vërejtjet, nuk janë shumë. Në fq. 15 janë paragrafët por që s'përputhet përmbajtja e tyre me tabelat, për shembull... Janë teknike, por duhet të përmirësohen...

Te fq. 22: ka mungesë përmbajtësore. Kemi bërë edhe disa analiza që, nuk përmenden askund. Por që ato analiza, kanë qenë bazë e rekomandimeve tona për Reformën Zgjedhore. Ato, edhe janë marrë për bazë... Këtu përmenden vetëm 2 analiza, por edhe të tjerat duhet të përshkruhen, bile me një apo dy paragrafë...

Pastaj, rregulloret ? Njëherë i kemi miratuar të gjitha në 2023. Tjetër është se jemi marrë me to edhe në vitin 2024!

Zyra e Auditimit: Është vetëm një paragraf me dy rreshta. Por, ka më shumë rekomandime, dhe është mirë. Ky është dokument për publikun...?

Me shumë detaje, janë pasqyruar zgjedhjet e “23 prillit”! Por, nuk mendoj që aq shumë i intereson kuvendit, publikut. S’i me kanë plani operativ...! Janë pa tepër...

Sfidat e KQZ...? Unë e kam n’i problem. Flasim për sfida, dhe kur vjen raporti, nuk ka ‘asnjë sfidë’! Nuk kam asgjë kundër, por raporti nuk përmend asnjë sfitë. Në bazë të sfidave, nxirren edhe rekomandimet...

Pjesët e raportit, duket që nuk punohen nga divizionet dhe departamentet. Kemi ba shumë takime me institucionet tjera. Këtu, nuk janë: takimet me ARC, Lista Votuese...

Përpunimi teknik i raportit, nuk është mirë: formati, distanca etj. Ky raport, momentalisht për mua nuk është i gatshëm...

Kreshnik Radoniqi: Ky raport nuk votohet sot. Nuk e di se cka është puna, por ju lutem merrni edhe më tutje...

Përfundoni, i keni vërjetjet, sot dhe nesër...

Në të “ndryshme”, unë i kam dy pika...

6. Të ndryshme!

Kreshnik Radoniqi: E kam pa një vendim të Adelina Dakut për një çështje kontesti! Askush nuk ka ba ankesë. Ajo, është ba e plotfuqishme pa ankesë! Askush nuk më ka njoftuar mua për asnjë proces, asnjë vendim, asnjë proces gjyqësorë... Kjo, për mua është shqetësuese...Së paku me më lajmerue. Ndoshta është e drejtë, nuk po them asgjë...

E dyta: mendimi ishte i ndarë në KCL: për vendimin përfundimtar për procesin në veri. Mendimi im është se ‘me konstatimin që e kemi ba, dhe që nuk e ka kalue 50%, ajo ka dështue dhe nuk kemi çka shkojmë tutje’. Por ka mendime që duhet me ba një shpallje të vendimit, shpallje të rezultatit të votimit në veri. Nëse gjithë mendoni se duhet me shpallë rezultatit: s’ka ankesa, s’ka asgjë, kanë kalue gjitha afatet...E marrim një vendim dhe e dorëzojmë...

Sami Hamiti: E marrim një vendim...?

Kreshnik Radoniqi: Nuk asht bash ashtu! Nuk mundesh me shpallë një rezultat, kur nuk ka rezultat. Por, unë përsëri po dua me pas një vendim... Nëse duam me marrë vendim, duhet me votue! Nëse nuk duam vendim, është ajo që në natën që 'e kemi konstatue', atë konstatim me e kthye në vendim. Edhe e japim arsyetimin, nuk kanë dalë 50%...

Nëse e lamë me të dielën. "Konstatimin", me protokollin e procesit e protokollojmë dhe, unë e nënshkruaj... Më tregoni çka me ba...?

Sami Kurteshi: Aspektin formal, ne duhet me e krye...

Alban Krasniqi: Pajtohem me shqetësimin e ngritur. Me shumë të drejtë... Nuk është vetëm kjo e personelit, janë konteste edhe me kompanitë. Këto janë obligative, duhet ta kemi një raport sepse, mund të na merren me qindra mijëra euro...

E dyta: procedutralisht, duhet të kompletohet procesi! Qysh të merreni vesh si shumicë, unë pajtohem...

Sami Kurteshi: Sa i përket çështjeve me drejtësinë...! Unë, personalisht, i ka nja tri vite që KQZ të informohet rregullisht për secilin proces...

Në këtë pikë, diskutuan sërish: Kreshnik Radoniqi, Alban Krasniqi etj.

Kreshnik Radoniqi: Kjo e dyta, si t'ia bëjmë...? A e fusim në rend dite kërkesën në KCL për me përmbyllë procesin e votimit...?

Anëtarët e KQZ-së, me 8 vota për dhe 1 abstenim (Gordana Llaban), e miratuan propozimin e kryetarit Radoniqi që, kjo çështje të shqyrtohet në KCL.

Kreshnik Radoniqi: A marrim edhe vendim: vendimi 'për shpalljen e rezultateve dhe dështimin e petitionit'.

Anëtarët e KQZ-së, me 8 vota për dhe 1 abstenim (Gordana Llaban), morën edhe këtë vendim...